



BULETIN MUJOR

SHTATOR 2025



PËRMBAJTJA

- Shqipëria ngjitet në vendin e 15-të në botë për sigurinë kibernetike sipas NCSI 2025
- Nënshkruhet amendimi i marrëveshjes AKSK–INSTAT për mbrojtjen e të dhënave
- Diplo 2025/ Siguria Kibernetike në fokus të diskutimeve
- AKSK organizon trajnim mbi Higjienën Kibernetike dhe Praktikat më të Mira të Sigurisë për sektorin shëndetësor
- AKSK dhe Ambasada Italiane në Tiranë thellojnë bashkëpunimin për sigurinë digjitale
- AKSK organizon workshop për vajzat dhe gratë në sigurinë kibernetike

Shqipëria ngjitet në vendin e 15-të në botë për sigurinë kibernetike sipas NCSI 2025



Shqipëria është renditur në vendin e 15-të globalisht me 85 pikë në National Cyber Security Index (NCSI) 2025, duke u ngjitur me 39 pozicione krahasuar me vitin 2023.

Ky progres reflekton përpjekjet e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) në forcimin e kapaciteteve kombëtare dhe ndërtimin e një kuadri të qëndrueshëm institucional e teknik.

Sipas NCSI, Shqipëria ka arritur përmbushje të plotë në fusha si:

- Korniza ligjore dhe institucionale
- Reagimi ndaj incidenteve dhe menaxhimi i krizave
- Mbrojtja e infrastrukturave kritike dhe të dhënave personale
- Ndërgjegjësimi publik dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

Ky rezultat e vendos Shqipërinë mes vendeve me performancën më të lartë në sigurinë kibernetike.



Nënshkruhet amendimi i marrëveshjes AKSK–INSTAT për mbrojtjen e të dhënave

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) dhe Instituti i Statistikave (INSTAT) nënshkruan amendimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, me synim rritjen e sigurisë së sistemeve të informacionit dhe mbrojtjen e të dhënave nga sulmet kibernetike.

Drejtori i Përgjithshëm i AKSK, z. Igli Tafa, theksoi angazhimin e Autoritetit për të mbështetur institucionet shtetërore në përballjen me kërcënimet kibernetike dhe për të ofruar trajnime praktike për stafin e INSTAT.

Ndërsa Drejtoresha e Përgjithshme e INSTAT, znj. Elsa Dhuli, vlerësoi mbështetjen e AKSK pas sulmit kibernetik të vitit 2024, duke theksuar se siguria digjitale është thelbësore për besueshmërinë e statistikave zyrtare dhe procesin e integritetit evropian të vendit.



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I Tiranë



www.aksk.gov.al



[@aksk.gov.al](https://www.instagram.com/aksk.gov.al)



+355 422 21 039

SHTATOR 2025



Diplo 2025/ Siguria Kibernetike në fokus të diskutimeve

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, z. Igli Tafa, mori pjesë në panelin mbi “Sigurinë Kombëtare dhe Kërcënimet Hibride”, zhvilluar në kuadër të konferencës Diplo2025, me praninë e ambasadorëve shqiptarë nga mbarë bota.

Në fjalën e tij, z. Tafa theksoi rolin thelbësor të sigurisë kibernetike në arkitekturën e mbrojtjes kombëtare, veçanërisht në një mjedis ku sfidat hibride po bëhen gjithnjë e më komplekse dhe të ndërlidhura me dimensionet tradicionale të sigurisë. Ai nënvizoi domosdoshmërinë e forcimit të kapaciteteve institucionale, rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe shkëmbimin e informacionit si elementë kyç për ndërtimin e qendrueshmërisë kibernetike.

Z. Tafa prezantoi gjithashtu prioritetet strategjike të vendit në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2025–2030.

AKSK organizon trajnim mbi Higjienën Kibernetike dhe Praktikat më të Mira të Sigurisë për sektorin shëndetësor

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, në bashkëpunim me CRDF Global dhe me mbështetjen e Departamentit Amerikan të Shtetit, organizoi trajnimin "Higjiena Kibernetike dhe Praktikat më të Mira të Sigurisë", të dedikuar për punonjësit e sektorit shëndetësor.

Ky trajnim u fokusua në parimet bazë të sigurisë kibernetike, përdorimin e sigurt të internetit, inteligjencën me burim të hapur (OSINT) dhe teknikat e inxhinierisë sociale.

Në aktivitet morën pjesë 400 pjesëmarrës online dhe 30 në sallë, duke krijuar një hapësirë të vlefshme për shkëmbim njohurish dhe praktikash të sigurta.

Ky aktivitet është pjesë e angazhimit tonë të vazhdueshëm për të rritur ndërgjegjësimin dhe aftësitë e profesionistëve në sektorët kritikë, duke siguruar një mjedis më të sigurt për qytetarët.



AKSK dhe Ambasada Italiane në Tiranë thellojnë bashkëpunimin për sigurinë digjitale

Në kuadër të forcimit të partneritetit mes Shqipërisë dhe Italisë, Drejtori i Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, z. Igli Tafa, priti në një takim Zëvendës Ambasadorin italian në Tiranë, z. Pierluigi Simonetti.

Diskutimet u përqendruan tek rëndësia e vijimit të bashkëpunimit të ngushtë në fushën e sigurisë kibernetike, në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit mes dy vendeve. Palët ranë dakord për hartimin e një plani të detajuar që përcakton fushat konkrete të bashkëpunimit, me synim forcimin e qëndrueshëm të sigurisë digjitale.

Në takim u theksua gjithashtu nevoja për shkëmbim të vazhdueshëm të ekspertizës mes dy vendeve, si një bazë e fortë për forcimin e kapaciteteve të përbashkëta.

AKSK hap thirrjen për Maratonën e Sigurisë Kibernetike dedikuar Vajzave dhe Grave

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) organizoi një workshop të dedikuar vajzave dhe grave në fushën e sigurisë kibernetike, me pjesëmarrjen e rreth 30 vajzave që morën pjesë në një “Cyber Drill” interaktiv për testimin e aftësive praktike.

Drejtori i AKSK, z. Igli Tafa, theksoi rëndësinë e përfshirjes më të gjerë të grave në këtë sektor dhe i inkurajoi ato të jenë ambasadore të ndryshimit në fushën e teknologjisë.

Ndërsa Ambasadori i OSBE-së në Shqipëri, z. Michel Tarran, vuri në dukje se siguria kibernetike është një çështje që prek gjithë shoqërinë, duke nxitur të rejtat të jenë pjesë aktive në ndërtimin e një të ardhmeje më të sigurt digjitale.



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I Tiranë



www.aks.gov.al



@aks.gov.al



+355 422 21 039